



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 94/6 Prot

Tiranë, më 28.01.2022

V E N D I M

Nr. 5, datë 28.01.2022

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, SIPAS KATEGORIVE TË INDIVIDËVE QË PLOTËSOJNË KRITERET E PRANIMIT NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE, NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE OSE NË NJË PROGRAM TË STUDIMEVE PROFESIONALE, QË PËRJASHTOHEN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 (faza e dytë)”

Bordi i Administrimit, mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale në pamundësi financiare për të mbuluar tarifat vjetore të shkollimit”, i ndryshuar me VKM Nr. 779, datë 26.12.2018, VKM Nr. 40, datë 23.01.2019, VKM Nr. 251, datë 27.03.2020, "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 269, datë 29.03.2017" si dhe referuar kërkesës së Administratorit të UBT-së me Nr. 94/5 Prot., datë 27.01.2022, në mbledhjen e tij të datës 28.01.2022,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve, sipas kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2021-2022 (faza e dytë) (sipas tabelës bashkëlidhur).
 2. Efektet financiare të këtij vendimi (për 45 studentë që plotësojnë kriterin) janë në vlerën 1,306,000 (një milion e treqindë e gjashtë mijë) lekë.
 3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori i UBT-së.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Arta	DOLLANI	Kryetar	
Sokol	DURO	Anëtar	
Fran	GJINI	Anëtar	
Donika	KËRÇINI	Anëtar	
Pjeter	GURALUMI	Anëtar	
Marin	MEMA	Anëtar	
Albert	KOPALI	Anëtar	

Konceptoi: N. Ndoci